

ANKETA E INOVACIONIT

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)
INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
4. Njësia matëse	Error! Bookmark not defined.
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	9
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente	12
Aneks	12

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Kërkim Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Olsa Ulqinaku
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës, Sektori i Statistikave të Kërkim Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	oulqinaku@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+ 355 (4)2 2233357/249
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	27.06.2024
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	27.06.2024
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	27.06.2024
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Vrojtimi statistikorë mbi aktivitetin e inovacionit kryhet një herë në dy vite dhe periudha e vëzhgimit mbulon një periudhë tre-vjeçare, 2020-2022. Vrojtimi ofron informacion të krahasueshëm mbi ndërmarrjet që zhvillojnë aktivitete inovacione produktesh dhe procesesh biznesi të prezantuara nga ndërmarrjet në Shqipëri.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimet e përdorura në statistikat e Inovacionit në ndërmarrje janë: • Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike (NVE Rev. 2) • Klasifikimi i Njësive Territoriale për Statistikat, (NUTS). Të dhënat janë prodhuar në nivel vendi, të klasifikuar në grup aktiviteteve të

	NVE Rev.2 dhe sipas madhësisë së ndërmarrjes.
3.3. Mbulimi i sektorit	Njësitë e vëzhguara janë të gjitha ndërmarrjet e sektorit jo-financiar dhe financiar me 10 ose më shumë të punësuar të angazhuar kryesisht në seksionet dhe ndarjet e mëposhtme të NVE Rev.2: • (B) Industri nxjerrëse; • (C) Industri Përpunuese; • (D) Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; • (E) Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve; • (G46) Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motorçikletave; • (H) Transporti dhe Magazini; • (J) Informacioni dhe Komunikacioni; • (K) Aktivitete financiare dhe të sigurimit; • (M71-73) Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike; aktivitete të kontrolleve dhe analizave teknike, Kërkim dhe zhvillim shkencor, Publiciteti dhe kërkimet e tregut.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	Një inovacion është një produkt ose proces i ri ose i përmirësuar (ose kombinimi i tyre) që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga produktet ose proceset e mëparshme të njësisë dhe që është vënë në dispozicion të përdoruesve të mundshëm (produkti) ose është sjellë në përdorim nga njësi (proces). Aktiviteti i inovacionit përfshin të gjitha aktivitetet zhvillimore, financiare dhe tregtare, të ndërmarra nga një ndërmarrje, të cilat synojnë ose rezultojnë në një inovacion. Një inovacion produkti është implementimi i një malli apo shërbimi që është i ri ose i përmirësuar dhe që ndryshon ndjeshëm nga mallrat ose shërbimet e mëparshme të ndërmarrjes. Një inovacion procesi biznesi është një proces biznesi i ri ose i përmirësuar për një ose më shumë funksione biznesi që ndryshon ndjeshëm nga proceset e mëparshme të biznesit të ndërmarrjes dhe i cili është prezantuar brenda ndërmarrjes. Inovacionet e procesit të biznesit përfshijnë metoda të reja ose të përmirësuara për: • Prodhimin e mallrave ose shërbimeve; • Shpërndarjen dhe logjistikën; • Marketingun dhe shitjet; • Sistemet e informacionit dhe komunikimit; • Administrimin dhe menaxhimin; • Zhvillimin e produktit dhe procesit të biznesit. Bashkëpunimi në inovacion është pjesëmarrje aktive me ndërmarrje ose organizata të tjera. Partnerët nuk kanë nevojë të përfitojnë ekonomikisht. Përfshihet kontraktimi i pastër nqs nuk ka bashkëpunim aktiv. Një ndërmarrje aktive në inovacion është një ndërmarrje e angazhuar për disa kohë gjatë periudhës së vëzhgimit në një ose më shumë aktivitete për të zhvilluar ose prezantuar produkte të reja ose të përmirësuara ose procese biznesi për një përdorim të synuar.

	Autoritetet publike përfshijnë autoritete lokale ose rajonale, Qeverinë qendrore (ku përfshihen agjencitë e qeverisë qendrore ose ministrive), Programin Horizon për Kërkimin dhe Inovacionin dhe çdo lloj mbështetje tjetër financiare nga një institucioni i Bashkimit Europian. Mbështetja financiare publike përfshin mbështetjen financiare përmes granteve, kredive të subvencionuara dhe garancive të kredive. Përfshihet financimi i aktiviteteve nën kontratë nga sektori publik.
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e synuar dhe e vrojtuar është ndërmarrja me mbi 10 të punësuar.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore përfshin të gjitha ndërmarrjet aktive në Shqipëri, të të gjitha formave ligjore. Baza e zgjedhjes janë të gjitha ndërmarrjet ku sipas Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve (RSN), janë aktive në Dhjetorin e vitit referencë për aktivitet që mbulon ky vërtetim, duke përfshirë: • Njësitë lokale; • Ndërmarrjet që kanë kodin e aktivitetit ekonomik kryesor (NACE rev.2) jashtë qëllimit të këtij vërtetimi; • Ndërmarrjet me më pak se 10 të punësuar.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e anketës së aktiviteteve të inovacionit në ndërmarrje mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat janë publikuar për herë të parë në 2020 për periudhën referuese 2017-2019.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Të dhënat mbi treguesit kryesorë të anketës së aktiviteteve të inovacionit në ndërmarrje publikohen vetëm në përqindje. Treguesit kryesorë janë si më poshtë: • Përqindja e ndërmarrjeve aktive në inovacion; • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë prezantuar inovacione produkti/procesi në biznes; • Përqindja e ndërmarrjeve inovative që kanë bashkëpunuar; • Përqindja e shitjeve neto të ndërmarrjeve aktive në inovacion; • Përqindja e të punësuarve në ndërmarrjet aktive në inovacion; • Përqindja e ndërmarrjeve që nuk janë aktive në Inovacion; Përqindja e ndërmarrjeve aktive në inovacion që morën mbështetje financiare nga autoritetet publike.
5. Periudha e referencës	Periudha referuese e informacionit statistikor mbi anketën e inovacionit është periudha tre vjeçare 2020-2022. Ky raport i përket vitit referencë 2022

6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore në nivel kombëtar për prodhimin e indikatorëve për statistikat e Inovacionit në Ndërmarrje janë: • Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare"; • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026. Baza ligjore përkatëse në nivel Evropian konsiston në: • Vendimi Nr. 1608/2003 / KE i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i 22 Korrikut 2003 në lidhje me prodhimin dhe zhvillimin e statistikave të Komunitetit për shkencën dhe teknologjinë; • Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 2022/1092 e 30 Qershorit 2022; • Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 995/2012 e 26 Tetorit 2012 që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e Vendimit Nr. 1608/2003 / KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me prodhimin dhe zhvillimin e statistikave të Komunitetit për shkencën dhe teknologjinë; • Manuali Oslo 2018, botimi i katërt.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Inovacionit në ndërmarrje transmetohen në Eurostat.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësive statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose

	b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave; Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësive statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendar i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Akses në kalendarin e publikimeve	Kalendar i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", statistikatat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit vjetor të Anketës së Inovacionit janë: 1. Njoftimi për shtyp; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Pjesa e informacionit e dedikuar për të kontaktuar INSTAT. 4. Shqipëria në Shifra.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	Rezultatet e Anketës së Aktiviteteve të Inovacionit në ndërmarrje publikohen në baza (2) dy vjetore.
10. Akses në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të siguruar nga vrojtimi si përqindja: e ndërmarrjeve aktive në Inovacion, e ndërmarrjeve që kanë prezantuar inovacione produkti/procesi në biznes, e ndërmarrjeve inovative që kanë bashkëpunuar, etj. Formati i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit. Njoftimi për shtyp i anketës së Inovacionit publikohet online në faqen e internetit të

	INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet e anketës së Inovacionit gjenden në faqen e internetit të INSTAT në temën Shkencë, Teknologji dhe Inovacion: Inovacioni .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Të dhënat e anketës të Aktiviteteve të Inovacionit në ndërmarrje janë të vendosura në databazën statistikore, por të dhëna të detajuara mund të gjenden në format Excel ku treguesit kryesorë jepen të detajuar sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë së ndërmarrjes. Këto tabela mund të gjenden në linkun: Databaza statistikore .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat e Anketës së Aktiviteteve të Inovacionit në Ndërmarrje nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodogjinë e përdorur mbi Statistikat e Inovacionit në ndërmarrje.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Kërkim Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e anketës së Inovacionit për qëllime të brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin "Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i	Të dhënat për Aktivitetet e Inovacionit në ndërmarrje krahasohen me të dhënat e

cilësisë	mbledhura dy vite më parë për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e të dhënave të Inovacionit ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Përdorues të jashtëm: • Institucione të administratës publike; • Universitetet; • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Bizneset; • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. Përdorues të brendshëm janë sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e Inovacionit në ndërmarrje si input në punën e tyre.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT analizon çdo vit klikimet e faqes web dhe klikimet në lidhje me temën “Inovacioni” për vitin 2023 janë 1,295. INSTAT kryen çdo vit vrojtimin për matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve. Rezultatet e vrojtimit për 2023 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Inovacioni" është vlerësuar me 4.04 pikë (80.8%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave të Anketës së Inovacionit gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregulloreve të ndjekura. Shkalla e plotshmërisë të të dhënave, për Anketën e Inovacionit 2020-2022 është 100%.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishme në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime të dhënave të anketës kontrollohen me pasqyrat financiare ose me burime administrative nëse ka informacion. Kur nuk ka informacion nga burimet administrative INSTAT korrigjon ose konfirmon të dhënat duke përdorur email ose duke telefonuar personat që i janë përgjigjur anketës. Masat e marra nga INSTAT çdo vit, për të rritur normat e përgjigjes, ose për të zvogëluar ndikimin e mos përgjigjeve janë si më poshtë: • Të dhënat merren drejtpërdrejt nga ndërmarrja; • Informacioni është mbledhur me intervistim i drejtëpërdrejtë nga anketuesit në bazë të udhëzimeve të përgatitura për këtë qëllim; • Stafi anketues është i trajnuar se si të sillen në mënyrë etike me rastet e personave të cilët refuzojnë të përgjigjen; • Për shkak të mungesës së sistemit të adresave, shpesh nga anketuesit është e vështirë gjetja e ndërmarrjes. Për këtë arsye, stafi i INSTAT nëpërmjet adresës së email-it ose numrit të telefonit kontakton personin

	përgjegjës për plotësimin e anketës dhe merr më tepër informacion mbi vendodhjen si edhe datën dhe orën e takimit; • Prioritet i jepet bizneseve të mëdha. Kur këto ndërmarrje refuzon të përgjigjet për intervistuesit, një kërkesë zyrtare i drejtohet presidentit të ndërmarrjes, e cila është e nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT; • Kërkesë zyrtare dërgohet edhe për ndërmarrje të tjera që pranojnë të përgjigjen vetëm nëse ju kërkohet zyrtarisht informacioni; • Ndërmarrjet janë të ftuar të kontaktojnë zyrat qendrore të Institutit të Statistikave në rast të pyetjeve dhe gjithmonë një staf i kualifikuar është në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga ndërmarrjet.								
13.2. Gabim i kampionimit	Treguesit e gabimeve të kampionimit janë llogaritur për indikatorët kryesorë, të cilët i gjeni në Tabelën A1 në Aneks. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e mos-përgjigjes në nivel rekordi për Anketën e Inovacionit 2020-2022 është 12.7%. Shkalla e mos-përgjigjes në nivel variabli për variablin "Shitjet neto të ndërmarrjeve aktive në Inovacion" është 0.0 %. Mbi-mbulimi ndodh kur ndërmarrja e zgjedhur është në një aktivitet të caktuar objekt i anketimit dhe gjatë procesit të intervistimit ajo nuk është më objekt i anketimit ose statusi i ndërmarrjes ka ndryshuar, nuk është më aktive. Shkalla e mbi-mbulimit për Anketën e Inovacionit 2020-2022 është 1.74%.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	Rezultatet e Anketës së Inovacionit janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 179 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 179 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Anketës së Inovacionit 2023 është 31 Dhjetori 2023. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2023</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>6/27/2024</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>179</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2023	Data e publikimit	6/27/2024	Afatet kohore	179		
Periudha referuese	12/31/2023								
Data e publikimit	6/27/2024								
Afatet kohore	179								
14.2. Përpikmëria	Të dhënat e Anketës së Inovacionit, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Anketës së Inovacionit ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100%. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2023</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>6/27/2024</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>6/27/2024</td></tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2023	Data e shpallur	6/27/2024	Data e publikimit	6/27/2024	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2023								
Data e shpallur	6/27/2024								
Data e publikimit	6/27/2024								
Vonesa në kohë	0								

15. Koherenca dhe Krahaseshmëria	
15.1. Krahaseshmëria gjeografike	Të dhënat e anketës së Inovacionit mbulojnë të gjithë territorin e vendit. Rezultatet që INSTAT prodhon janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat. Për të siguruar krahasueshmëri në të gjithë vendet, Eurostat në bashkëpunim të ngushtë me Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet e tjera zhvilluan një pyetësor bazë standard, duke e shoqëruar me përkufizime dhe rekomandime metodologjike të miratuara nga të gjitha vendet dhe që janë plotësisht në përputhje me përkufizimet në manualin metodologjik “Manuali i Oslos”.
15.2. Krahaseshmëria kohore	Informacioni statistikor grumbullohet në po të njëjtën mënyrë prej viti 2015. Pyetësi i përdorur për këtë vërtetim është në përputhje me pyetësit e përdorur nga vendet anëtare për periudhën referuese. Duke filluar nga viti 2020 e në vazhdim, të dhënat do të publikohen rregullisht.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohet përpara se të finalizohet. Kontrollohen lidhjet ndërmjet variablave dhe konfirmohet koherenca midis serive të brendshme të të dhënave të ndryshme.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Personeli që punon për Anketën e Inovacionit janë: 1 punonjës në Zyrën Qendrore, 11 Personel në Zyrat Rajonale, 44 anketues, 3 staf Kontrollorë dhe 1 staf i IT.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të Anketës së Inovacionit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë: • Politika e revizionimit; • Politika e trajtimit të gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	Të dhënat e vërtimit të Inovacionit rishikohen kur: • Zbatohet një klasifikim i ri i aktiviteteve ekonomike; • Ekzistojnë ndryshime metodologjike; • Rishikimi i peshave (burime të reja dhe/ose të përmirësuara të të dhënave, korrigjime të gabimeve).
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Të dhënat mbi Inovacionin janë të bazuara në vërtetim. Popullata e përzgjedhur për inovacionin 2020-2022 përmban 3,793 ndërmarrje. Madhësia e kampionit të zgjedhur është 1,663 ndërmarrje e të gjitha formave ligjore dhe llojeve të pronësisë, me 10 e më shumë të punësuar, nga të cilët të përgjigjur ishin 1,426

	ndërmarrje.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Frekuenca e Anketës së Inovacionit është dyvjeçare.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat e Inovacionit mblidhen me intervistim të drejtpërdrejtë me tabletë nga anketuesit, në ndërmarrjet e zgjedhura për anketim. Krahas të dhënave të grumbulluara nga anketa, sektori i statistikave të Kërkim Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit analizon dhe përdor të dhënat nga vërtetimet e viteve të kaluara për Inovacionin në ndërmarrje. Programet dhe procedurat e nevojshme për hedhjen manuale të të dhënave përgatiten para se të fillojë mbledhja e të dhënave. Paraprakisht procedurat dhe programet e nevojshëm janë testuar dhe janë bërë korrigjimet eventuale. Të gjitha të dhënat janë të integruara në një bazë të dhënash të vetme, pasi është kryer hedhja dhe kontrolli i të dhënave. Para kryerjes së anketës përdoruesit kryesorë pyeten mbi nevojat që ata kanë për shtim të pyetjeve në pyetësor. Bazuar në rezultatet e këtyre nevojave bëhet dhe dizajni final i pyetësorit i cili nuk ka ndryshime të mëdha në vite. Faza e rëndësishme në përgatitjen për grumbullimin e të dhënave është përgatitja e të gjitha materialeve të nevojshme dhe e programeve të hedhjes dhe të përpunimit të të dhënave. Duhet që të jenë përcaktuar ndërmarrjet që do intervistohen, numri i nevojshëm i anketuesve dhe duhet të jetë bërë përzgjedhja e tyre. Gjatë trajnimit të organizuar për anketuesit se si të kryejnë vërtetimin ata gjithashtu pajisen materiale të nevojshme si udhëzuesi i pyetësorit, detyrat e anketuesit, lista e aktiviteteve ekonomik, lista e produkteve, letër njoftimit për ndërmarrjet etj. Në procesin e mbledhjes së të dhënave janë të regjistruar çdo gjë e raportuar nga ndërmarrjet. Në rast të paqartësive, ndërmarrja ri-kontaktohet. Në rast të mospërgjigjes, ndërmarrjes i dërgohet një shkresë zyrtare e nënshkruar nga titullari i Institucionit.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e redaktimit të të dhënave në përgjithësi i referohen redaktimit në nivel mikro ose ndryshe në nivel ndërmarrje. 1. Kontrolli i të dhënave të hedhura në program. • Kontrolli i pyetësorëve të hedhur, kontrole të tërësisë së plotësisë, saktësisë së vlerave dhe kontrollit logjik i pyetësorit. Numri i pyetësorëve të hedhur në program duhet të jetë i barabartë me numrin e shpërndarjes së pyetësorëve në qarqe; • Kontrole individuale janë bërë për rastet e refuzimit dhe pa kontakte; • Ndërmarrjet e përgjigjura kontrollohen për koherencën e të dhënave midis sesioneve të ndryshme të pyetësorit. 2. Kontrolli i disa pyetjeve me anë të informacionit që mund të gjendet nga kontaktimi individual i ndërmarrjeve. 3. Pësia e përshtatshme ri-llogaritjet për çdo njësi që ka raportuar të dhënat e saj. Kjo pësia është ri-llogaritjet për arsye të ndryshme: kemi probabilitet të pabarabartë të përzgjedhjes, mos-përgjigje, ndërmarrje që dalin jashtë qëllimit. Trajtimi i outlier-ave merret parasysh në procedurat e përgjithësimin të rezultateve.

18.5. Përpilimi i të dhënave	Për përpilimin e rezultateve kemi dy procedura bazë: 1. Analiza e cilësisë së të dhënave Për të analizuar cilësinë e të dhënave janë aplikuar disa rregulla: • Kontrolli matematik i anketës - Kontrolli logjik i të dhënave të anketës; • Krahاسimi i të dhënave në seri kohore - Krahاسimi i të dhënave me skedarë të tjerë që disponon INSTAT; • Krahاسimi i të dhënave me skedarin e bilanceve; • Përcaktimi i kufizimeve për disa raporte, si psh: paga mesatare për të punësuar, marzhet ndaj shitjes neto, etj; • Analiza e shmangieve të mëdha nga mesatarja. 2. Trajtimi i mos-përgjigjeve Konsiderohen si mos-përgjigje të gjitha rastet: • Pa kontakt; • Refuzim i plotë; • Refuzime të pjesshme, (për tabela apo tregues të veçantë). Për trajtimin e mos-përgjigjeve të pjesshme u përdorën disa metoda të drejtpërdrejta ose kombinimi i tyre si: • Studimi i serisë kohore të ndërmarrjes dhe degës; • Të dhënat nga skedari i bilanceve; • Skedarët e tjerë që disponohen në INSTAT; • Analizohen dhe përdoren të dhënat mesatare të degës ku bën pjesë ndërmarrja; • Përdoren të dhënat e ndërmarrjeve që kanë kushte të ngjashme; • Për pjesën e pa trajtuar përdoret metoda e ri-peshimit.	
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.	
19. Komentë		
Aneks		
Tabela A1. Vlerësimet në përqindje të treguesve kryesorë për anketën e Inovacionit 2020-2022 së bashku me treguesit e saktësisë respektive		
Indikatorët	2020-2022	Koeficienti i Variacionit %
Përqindja e ndërmarrjeve aktive në Inovacion	42.87	0.9
Të punësuarit në ndërmarrjet aktive në Inovacion	51.76	4.8
Përqindja e ndërmarrjeve që kanë të paktën një inovacion produkti	25.65	1.4
Përqindja e ndërmarrjeve që kanë të paktën një inovacion procesi biznesi	36.30	1.3
Ndërmarrje me të paktën një inovacion produkti që nuk ishte i ofruar më parë në treg	43.17	1.4
Ndërmarrje aktive në inovacion që kanë bashkëpunuar	29.98	1.0